



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1329/2 prot.

Datë 29.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK dhe operatori ekonomik “ATLANTIK 3” në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02880-04-29-2024, me objekt: “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore, Bashkia Berat”, me fond limit 2,249,474.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Berat.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F. me NIPT L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Berat
Rruga Antipatrea.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Lushnjë.
- Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK me NIPT K22218003V dhe adresë: Autostrada Tirane - Durrës, Km. 10, Rruga dytesore Vore – Albania.

Në datën 28.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4124, si dhe nr. protokollit 1329/2024 datë 28.05.2024, i operatorit ekonomik “Besim Kamberi” P.F për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-02880-

04-29-2024, me objekt: “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore, Bashkia Berat”, me fond limit 2,249,474.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Berat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “4 S” SHPK dhe “ATLANTIK 3” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Besim Kamberi” P.F pretendon se nuk përmbushen nga secili prej operatorëve ekonomikë “4 S” SHPK dhe “ATLANTIK 3” SHPK. pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht:

I. Operatori ekonomik “4 S” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

2.3.5. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

Magazine për mbajtjen e materialeve dhe produktet e pastrimit të pastrimit në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, kur ambjenti është në pronësi duhet të jete I pajisur me:

- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
- Akt-miratim higjieno sanitar
- Çertifikatën e dezinfektimit 3D
- Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit.

Në rastin se nuk kanë magazine në pronësi ose me qira ose përdorim duhet të paraqesin një kontratë furnizimi për produktet objekt prokurimi.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.6. Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin nga një mostër të produkteve të kërkuara për t'i krahasuar ato me specifikimet teknike dhe specifikiht për produktet e pastrimit .

- Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit deri në orën 10 :00.

Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikimi

MATERIALE PASTRIMI 2024	
Nr.	EMERTIMI
9	Kova larje + shtrydhese 13 litra. Kova larje + shtrydhese e cilësisë së lartë, të thella dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës. Të kenë mekanizëm plastik vetë-shtrydhese për shtupën.
16	Shtupa dysheme mikrofiber. Shtupë pastrimi mikro-fiber e përbërë nga materiali 100% pambuk i pastër me fije të prerë në gramaturë 280 gr për absorbueshmëri të madhe dhe të jenë të gjata. I përshtatshëm për pastrim industrial.
2	Bishta fshese druri. Bishta fshese druri me gjatësi normale,dhe të jenë rezistente.
3	Detergjent larje enesh 400 gr(xhel). Pastrues larës enësh xhel.Solucion larje enësh, paketim plastik. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrnave, të jetë i ambalazhuar me enë plastike. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika dhe të ketë analizën spektrale në ambalazhim. Paketim plastik 400 gr.

2.3.7. Materialet e Pastrimit te jene cilësore sipas preventivit dhe specifikimeve teknike te mallrave, Afati i skadences: (per mallrat te cilat kane skadence) data e skadences ne ditën e levrimit te mallit duhet te jete jo me e vogel se ½ e kohes ndermjet dates se prodhimit dhe asaj te skadences.

MATERIALE PASTRIMI 2024	
Nr.	EMERTIMI
4	Detergjent larje lavatrice 3kg (ambalazh plastik). Të jetë pluhur, të jetë 100% i tretshëm në ujë, të veprojë shpejt mbi njollat e ndryshme duke i eliminuarato, të jetë aromatik, të mos ketë efekte anësore në ngjyrat dhe butësinë e rrobave, të jetë i ambaluzhuar ne qese plastike me peshë 3 kg. Përberja 5-15 % tensed anjonik,<5% polikarboksiklat, tensed jo-jonik, fosfonat, zeolite, enzima, substanca aromatizuese (citronellool,geranl,hexylxinamal,linalool,)
12	Qese plehrash 75lit.

	Një pako të ketë 10 fije (qese). Mundesojnë grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme. Të jenë të forta. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë me lidhëse.
16	Shtupa dysheme mikrofiber. Shtupë pastrimi mikro-fiber e përbërë nga materiali 100% pambuk i pastër me fije të prerë në gramaturë 280 gr për absorbueshmëri të madhe dhe të jenë të gjata. I përshtatshëm për pastrim industrial.
18	Acid ëc 1lit/bidoni. Acid përpastrim EC, të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë HCL jo më pak se 30%. Gjëndja fizike e lëngut të jetë lëng i pastër, i bardhë .Të jetë i tretshëm në ujë.

- II. Operatori ekonomik “Atlantik 3” SHPK nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 e më konkretisht:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike

	MATERIALE PASTRIMI 2024
Nr.	EMERTIMI
1	Aromatizues rrobash 3 liter/bidoni. Detergjent për aromatizues të jetë i lëngshëm, të shërbej për zbutjen e rrobave dhe aromatizimin e tyre, të jetë me aromë luleje, të zvogëlojë kohën e tharjes, si dhe të ndihmojë për të pastruar dhe zvogëluar rrudhosjen e rrobave, të parandalojë zbehjen e ngjyrave.
17	Sfungjer me tel larje enesh. Sfungjer për larjen e enëve me dorë, sipërfaqe me material gërryes për të hequr njollat e vështira dhe në pjesën e brendëshme material sfungjer. Përmasat e sfungjerit të jenë minimumi 13 cm x 9 cm.
21	Fshirse xhamash+ bisht . Paisje me gomë dhe sfungjer për larjen e xhamave me bisht zgjatues metalik. Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham.
12	Qese plehrash 75lit. Një pako të ketë 10 fije (qese). Mundesojnë grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme. Të jenë të forta. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë me lidhëse.
16	Shtupa dysheme mikrofiber. Shtupë pastrimi mikro-fiber e përbërë nga materiali 100% pambuk i pastër me fije të prerë në gramaturë 280 gr për absorbueshmëri të madhe dhe të jenë të gjata. I përshtatshëm për pastrim industrial.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 29.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro